



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË



Korçë, më datë 18/11/2024

Proces-verbal

Proces-verbal i mbajtur sot më datë 15 Nëntor 2024, ora 10:00-12:00 në kuadër të takimeve që Bashkia Korçë organizon me grupet e interesit për diskutimet për Paketën Fiskale të vitit 2025. Pjesë e panelit të diskutimit ishin Kletjon Kita Zv. Kryetar Bashkia Korçë, Soniel Prifti Drejtori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Korçë, Albert Nasto Kryetar i Shoqatës së Biznesit të Vogël dhe të Mesëm të Shqipërisë, si edhe përfaqësues të bizneseve.

Gjatë këtyre takimeve u vu në dukje:

- Lehtësi fiskale lidhur me tarifatat për subjektet që shërbejnë me tavolina jashtë lokalit, sidomos për muajt Dhjetor, Janar, Shkurt.
- Bashkëpunimi i ndërsjellë që Shoqata e Biznesit të Vogël dhe të Mesëm të Shqipërisë ka me Bashkinë Korçë.
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve që bashkia ofron për bizneset.
- Këshillim për aplikim në programe financimi ose grante të ofruara nga shteti apo organizata ndërkombëtare.
- Organizimi i panairove ose aktiviteteve promovionale për bizneset lokale.
- Promovimi i bizneseve lokale në faqen zyrtare të bashkisë ose rrjetet sociale.

Pas diskutimit në lidhje me Paketën Fiskale për vitin 2025, Bashkia Korçë garantoj përfaqësuesit e bizneseve se nuk do të ketë asnjë ndryshim në taksat dhe tarifatat vendore nga ajo e vitit 2024.

Gjatë takimeve të organizuara përfaqësues të bizneseve, ekspertët kontabël dhe kryetari i shoqatës listuan kërkesat si më poshtë vijon:

- Ulja e çmimit të tarifës për shfrytëzim të hapësirës publike për subjektet të cilat shërbejnë me tavolina jashtë lokalit. Përfaqësues të ndryshëm të bizneseve u shprehën se gjatë muajve Dhjetor, Janar, Shkurt këto hapësira nuk i shfrytëzojnë për shkak të kushteve atmosferike.
- Problem në zonën këmbësore me hedhjen e mbeturinave tek koshat e vegjël nga subjektet që ushtrojnë aktivitet. Edhe pse ndaj këtyre subjekteve janë marrë masa këshilluese nga ana e bashkisë, u kërkua që nëse është e nevojshme të merren masa administrative për t'i dhënë zgjidhje.
- Mirëmbajtje e bazave të luleve tek “Pazari i Vjetër” apo “Zona Këmbësore”, sepse dëmtohen nga qytetarët.
- Problematikë me qentë endacakë sepse përbëjnë rrezik për këmbësorët, veçanërisht në pedonale.
- Ndërgjegjësim i shtuar ndaj bizneseve në lidhje me ndryshimet që janë bërë ose të cilat do të bëhen në taksat dhe tarifave vendore. Kjo sepse kur jemi përballur me rritjen e tyre jemi informuar vetëm kur na ka ardhur njoftimi nga ana e bashkisë, por në ky njoftim nuk na është arsyetuar rritja.
- Ekspertët kontabël, u shprehën se si përfaqësues të disa subjekteve kanë vështirësi për të marrë informacion pa qenë vetë prezent subjekti.
- Disa biznese tek rruga nacionale Korçë-Ersekë, Km.I kanë probleme me ndriçimin publik, pjesa më e madhe e ndriçuesave është jashtë funksionit.

Sipas përfaqësuesve të biznesit të madh kjo tavolinë diskutimi është shumë e vlefshme pasi nxjerr në pah nevojat e bizneseve dhe në të njëjtën kohë i kushtohet më tepër kujdes politikave fiskale.

Biznesi dhe subjektet fashonë ishin shumë të kënaqur me ndërhyrjen që ishte bërë nga ana e Bashkisë Korçë për tërheqjen e mbetjeve teknologjike dhe industriale, problematikë që ishte ngritur gjatë takimit të vitit të kaluar. Zgjidhja e këtij problemi ka ulur kostot e tyre.

Nga Bashkia Korçë u garantuan subjektet se nuk do të ketë ndryshim të nivelit të taksave dhe tarifave vendore në Paketën Fiskale 2025.





